



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
KOMISIONI DISIPLINOR**

Nr. 1/2018 Regjistri (JD)

Nr. 1 Vendimi, datë 12.03.2018

**V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Komisioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, i përbërë nga:

Sokol Çomo	Kryesues
Albana Shtylla	Anëtar
Ardian Hajdari	Anëtar

me sekretare gjyqësore Manjola Islamaj, në Tiranë, sot më datë 12.03.2018, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike, procedimin disiplinor që i përket anëtarit të institucioneve të rivlerësimit:

Z. Heral Saraçi - Komisioner Publik, i mbrojtur nga Avokat Shaqir Hasanaj, me nr. 1300 licence dhe NUIS K31602019H

Gjyqtar Hetues - Natasha Mulaj, Gjyqtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese

OBJEKTI: Shqyrtimi i procedimit disiplinor ndaj Komisionierit Publik Heral Saraçi.

BAZA LIGJORE: Neni C, pika 16 i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI DISIPLINOR

pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike, procedimin disiplinor ndaj Komisionierit Publik Heral Saraçi,

V Ë R E N:

I.

Me shkresën nr. Ref. No: AC/21/2018, datë 09.02.2018, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me lëndë: “Kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor ndaj Komisionerit Publik Heral Saraçi”, bazuar në nenin C pika 16 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 16 pikat 4, 5, 7 dhe 8 dhe nenit 17 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vëzhguesit ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, mbi bazën e të dhënave të mjaftueshme nga burime të besueshme kanë kërkuar fillimin e hetimit disiplinor ndaj Komisionerit Publik Heral Saraçi.

Kjo kërkesë është nënshkruar rregullisht nga 7 vëzhgues ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, nga 8 gjithsej.

Kërkesa është protokolluar në Zyrën e Protokollit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me nr. 86 Prot., datë 09.02.2018.

Në këtë kërkesë vëzhguesit ndërkombëtarë kanë pretenduar se veprimet e Komisionerit Publik Heral Saraçi përbëjnë një kërcënim për forcën vepruese të Institucionit të Komisionerit Publik dhe pozicionin e Komisionerit Publik në procesin e rivlerësimit kalimtar në tërësi, si pasojë e mospërbushjes së përgjegjësisë të tij ligjore në lidhje me miratimin e Rregullores së Institucionit të Komisionerëve Publikë si dhe krijimit të vonesave të panevojshme në rekrutimin e stafit të Komisionerëve Publikë.

Gjithashtu, vëzhguesit ndërkombëtarë kanë pretenduar se me veprimet dhe mosveprimet e tij Komisioneri Publik Heral Saraçi ka vepruar në mënyrë jobashkëpunuese me Institucionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke penguar procesin e rekrutimit të stafit ligjor të këtij institucioni dhe se kjo sjellje përbën kërcënim për forcën vepruese të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe pozicionimin e tij në procesin e rivlerësimit (*vetting process*).

Për rrjedhojë të sa më sipër, vëzhguesit ndërkombëtarë janë të mendimit se ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme nga burime të besueshme për të filluar dhe kryer një hetim disiplinor ndaj Komisionerit Publik Heral Saraçi sipas dispozitave të Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si më poshtë vijon:

neni 16 pika 4 “Ndërhyrje në ushtrimin e detyrës të një anëtari tjetër”;

neni 16 pika 5 “Mospërbushje e pajustificuar, e qëllimshme dhe e përsëritur e funksioneve përkatëse”;

neni 16 pika 7 “Shkelje e rregullave të sjelljes në marrëdhënie me anëtarët e institucioneve të rivlerësimit”;

neni 16 pika 8 “Vonesa të përsëritura dhe të pajustificuara dhe zvarritje të veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit”.

Në përfundim të analizës së tyre, vëzhguesit ndërkombëtarë, duke vlerësuar pasojat e veprimeve dhe mosveprimeve të Komisionerit Publik Heral Saraçi, në raport me gjendjen në institucionin e

Komisionerit Publik dhe Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, janë të mendimit se ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme për të filluar dhe kryer një hetim disiplinor ndaj tij.

Vëzhguesit ndërkombëtarë nënshkrues i kanë kërkuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të ndërmarrë procedurat e nevojshme.

Si pasojë e kësaj kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor në ngarkim të Komisionerit Publik Heral Saraçi, në përputhje me parashikimet e nenit 17, pika 4 të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit organizoi shortin, sipas të cilit u shortua gjyqtari hetues dhe përbërja e Komisionit Disiplinor, vërtetuar kjo me procesverbalin e Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 12.02.2018, ora 9.30 “Për hedhjen e shortit për zgjedhjen e gjyqtarit hetues dhe gjyqtarëve të Komisionit Disiplinor” dhe procesverbalin e Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit datë 12.02.2018, ora 16.55 “Për hedhjen e shortit për zgjedhjen e gjyqtarit hetues”.

Në vijim gjyqtari hetues, me vendimin nr. 1, datë 14.02.2018 “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj Komisionerit Publik Heral Saraçi” vendosi fillimin e hetimit disiplinor ndaj anëtarit të institucionit të rivlerësimit Komisionerit Publik Heral Saraçi, si dhe njoftimin e tij për ushtrimin e së drejtës për t’u njohur me dosjen e hetimit. Ky vendim i është komunikuar Komisionerit Publik Heral Saraçi me anë të shkresës nr. 99 Prot., datë 14.02.2018.

Në kuadër të hetimit disiplinor, gjyqtari hetues kreu veprimet hetimore të çmuara si të nevojshme prej tij për hetimin disiplinor dhe në përfundim të tyre, me Vendimin Nr. 2, datë 26.02.2018 “Për përfundimin e procedurës hetimore ndaj Komisionerit Publik Heral Saraçi” vendosi përfundimin e procedurës hetimore, depozitimin menjëherë të Raportit Hetimor dhe dosjes hetimore pranë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për fillimin e procedimit disiplinor ndaj Komisionerit Publik Heral Saraçi për shkeljet disiplinore të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si më poshtë vijon:

neni 16, pika 4 “Ndërhyrje në ushtrimin e detyrës të një anëtarit tjetër”;

neni 16, pika 5 “Mospërmbushje e pajustificuar, e qëllimshme dhe e përsëritur e funksioneve përkatëse”;

neni 16, pika 7 “Shkelje e rregullave të sjelljes në marrëdhënie me anëtarët e institucioneve të rivlerësimit”;

neni 16, pika 8 “Vonesa të përsëritura dhe të pajustificuara dhe zvarritje të veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit”.

Ky vendim i është njoftuar Komisionerit Publik Heral Saraçi, me anë të shkresës së Kryetares së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit Nr.125 Prot., datë 26.02.2018, konfirmuar marrja nga Komisioneri Publik Heral Saraçi, në të njëjtën datë.

Komisioni Disiplinor, më datë 27.02.2018, pasi u njoh me Raportin e gjyqtarit hetues Natasha Mulaj mbi rezultatet e hetimit disiplinor ndaj Komisionerit Publik Heral Saraçi dhe aktet bashkëlidhur këtij Raporti, të depozituara pranë tij më datë 26.02.2018, njoftoi me shkrim

Komisionerin Publik Heral Saraçi nëpërmjet Aktit të Njoftimit Nr. 1/2018 Regjistri (JD), datë 27.02.2018 për Raportin e gjyqtarit hetues mbi rezultatet e hetimit disiplinor dhe aktet bashkëlidhur këtij Raporti, si dhe i dorëzoi aktet e mësipërme, sipas procesverbalit të datës 27.02.2018, nënshkruar rregullisht edhe nga Komisioneri Publik Heral Saraçi.

Në të njëjtën datë, Komisionerit Publik Heral Saraçi iu dorëzua edhe Akt Njoftimi Nr. 1/2018 Regjistri (JD), datë 27.02.2018 për zhvillimin e seancës dëgjimore, ditën e hënë, datë 05.03.2018, ora 12.00 në mjediset e Pallatit të Kongreseve, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 6, Tiranë, ku aktualisht zhvillon veprimtarinë Kolegji i Posaçëm i Apelit. Me anë të këtij Akt Njoftimi, Komisionerit Publik Heral Saraçi iu bënë me dije gjithashtu edhe të drejtat e tij gjatë procedimit disiplinor.

II.

Nga shqyrtimi i procedimit disiplinor, rezultoi se:

Vëzhguesit Ndërkombëtarë në kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor, lidhur me veprimtarinë e Komisionerit Publik Heral Saraçi në Institucionin e Komisionerit Publik, kanë parashtruar rrethanat e faktit si më poshtë:

“Lidhur me miratimin e rregullores së institucionit të Komisionerit Publik

Neni 69, paragrafi 3 i LV kërkon prej Komisionereve Publikë (KP) miratimin e rregullave të brendshme për institucionin e tyre brenda tridhjetë ditëve nga momenti i krijimit të tij. Megjithëse kanë kaluar disa muaj nga ky afat, Komisionerët Publikë kanë dështuar në arritjen e dakordësisë për rregulloren e tyre.

Vëzhguesit Ndërkombëtarë janë takuar rregullisht me KP për të zgjidhur këtë çështje pasi kanë dhënë dhe komentet e kërkuara mbi draftin e parë të kësaj rregulloreje që nga korriku 2017.

Përgjithësisht ka qenë Komisioneri Ballhysa që ka ndërmarrë detyrën e draftimit të rregullores, e cila është rishikuar në vijim nga VN, ndërkohë që Komisioneri Saraçi ka pasur pjesëmarrje të ulët në procesin e hartimit dhe më tepër është marrë me kundërshtimin e disa dispozitave të caktuara dhe prezantimin e disa dispozitave të tjera në vend të tyre.

Shumë versione janë krijuar deri në një takim të përbashkët të VN me të dy KP në dhjetor të vitit 2017, në të cilin zoti Saraçi ra dakord që e vetmja çështje e mbetur lidhur me projektregulloren ishte nëse autoritetin ligjor përfundimtar për të marrë në punë stafin e ka Komiteti Ad Hoc pranë Institucionit të Komisionerit Publik, siç mbështeste Saraçi apo mbledhja e Komisionerve Publikë, sipas qëndrimit të Ballhysës.

U ra dakord që ONM do të siguronte një interpretim ligjor mbi këtë çështje, por në opinionin e VN, kjo nuk duhet të pengonte KP nga dakordësimi mbi një projekt të rregullores së tyre, e cila do të përcaktonte zbatimin e ligjit pa bërë një interpretim të caktuar të tij.

Duke qenë që nuk u arrit asnjë marrëveshje gjatë takimit të VN me dy KP në 4 janar 2018, ONM kërkoi që KP të prodhonin një draft rregullore të miratuar dhe nënshkruar deri më datë 8 janar 2018. Në takimin e mëngjesit të asaj date, z. Saraçi në vend që të sillte një projekt si më sipër, paraqiti sërish projektin e tij, që përmbante sërish një numër dispozitash të kontestuara dhe të zgjidhura më parë.

VN i kërkuan të dy Komisionerëve Publikë të përpiqeshin të zgjidhnin ndryshimet në qendrime deri në pasditen e asaj dite dhe të informonin VN për rezultatin. Në fund të asaj pasditeje nuk u nënshkrua asnjë rregullore. Deri më sot, akoma nuk ka një rregullore të miratuar nga Komisionerët Publikë.

Që nga tetori 2017 z. Saraçi ka vazhduar të mbajë qendrimin që ligji nuk i jep Komisionerëve Publikë kompetencë për të thirrur mbledhjen e Komisionerëve, për të adresuar qoftë çështjen e miratimit të rregullores, sipas nenit 69, apo për të filluar procesin e rekrutimit të stafit.

Ky qendrim ligjor është i papranueshëm në opinion të VN dhe ka vonuar progresin në raport me të dy këto aktivitete për muaj me radhë.

Lidhur me rekrutimin e stafit të KP

Komiteti Ad Hoc i KP përbëhet nga dy Komisionerët Publikë dhe z. Luan Daci, anëtar i Kolegjit të Apelimit dhe gjithashtu për shkak të ligjit anëtar i Komitetit Ad Hoc të KP. Kur Komiteti Ad Hoc i KP më në fund u mblodh më datë 5 janar 2018 për të vlerësuar kandidatët për pozicione të ndryshme, z. Ballhysa dhe z. Daci firmosën procesverbalin dhe listën e kandidatëve për t'u intervistuar. Z. Saraçi nuk do ta firmoste.

Duke filluar nga janari 2018, VN vendosën të intensifikonin monitorimin e performancës së z. Saraçi në Komitetin Ad Hoc të institucionit të KP, në përpjekje për të lehtësuar procesin e rekrutimit të stafit dhe e njoftuan z. Saraçi verbalisht për këtë vendim. Që prej këtij momenti VN kanë qenë prezent në pjesën më të madhe të takimeve të Komitetit Ad Hoc.

Pas shqyrtimit të shumë aplikimeve dhe vlerësimit të kandidatëve, Komisionerët Publikë ranë dakord të punësojnë kandidatë të caktuar si stafin e tyre ligjor. Në datën 2 shkurt 2018, në prezencë të VN, të dy Komisionerët ranë dakord të takohen dhe të nënshkruajnë kontratatën e punës së këshilltarëve ligjorë të përzgjedhur, ditën e hënë 5 shkurt 2018.

Në datë 5 shkurt 2018 z. Saraçi nuk u paraqit në takim, dhe për këtë nuk kishte bërë asnjë njoftim/shpjegim paraprak Komisionerit tjetër, me pasojë mosnënshkrimin e kontratave të punës. Më vonë gjatë asaj jave z. Saraçi insistoi në përdorimin e një kontrate pune e cila përmbante dy dispozita të cilat nuk kishin bazë ligjore.

Kjo gjë shkakton jo vetëm pengesë/amulli në rekrutimin e stafit në Institucionin e KP, por gjithashtu krijon pasiguri për kandidatët e përfshirë, disa prej të cilëve kanë lënë punën e mëparshme dhe po punojnë tashmë në zyrat e KP, për disa dite pa pasur një kontratë pune. Deri më sot, vetëm 6 nga 26 persona të stafit të këtij institucioni janë përzgjedhur.

Gjatë gjithë periudhës, nga korriku 2017 deri në këtë moment z. Saraçi nuk ka punuar në mënyrë konstruktive në drejtim të zgjidhjes së këtyre çështjeve që janë thelbësore për funksionimin e institucionit të KP. Përkundrazi, z. Saraçi e ka kufizuar pjesëmarrjen e tij në procesin e hartimit të rregullores vetëm në ngritjen e kundërshtimeve të kota (frivolous), nuk i ka qendruar marrëveshjeve dhe ka vonuar procesin e marrjes në punë bazuar në pretendime ligjore të parëndësishme.

Pasoja e veprimeve të z. Saraçi është:

- 1) Rregullorja e KP-së është ende në pritje të miratimit, fakt ky që cenon transparencën lidhur me funksionimin e institucionit, për të cilën subjektet rivlerësuese dhe publiku kanë të drejtë; dhe
- 2) Funksionimi i institucionit të KP është dëmtuar nga një vonesë e panevojshme në rekrutimin e stafit.”

Për faktet dhe pasojat e analizuara si më sipër, vëzhguesit ndërkombëtarë kanë arritur në konkluzionet si vijon:

“Në kundërshtim me përgjegjësitë e tij si Komisioner Publik, veprimet e z. Saraçi nuk reflektojnë një dëshirë të sigurtë për të bashkëpunuar me kolegun e tij, me qëllim për të zgjidhur diferencat mes tyre për të mirën e përgjithshme të institucionit të Komisionerit Publik dhe procesit të rivlerësimit (vetting process) në tërësi.

Veprimet e z. Saraçi përbëjnë një kërcënim për forcën vepruese të Institucionit të KP-së dhe pozicionit të tij në procesin e rivlerësimit.

Duke përmbledhur sa më sipër, vëzhguesit ndërkombëtarë nënshkruan janë të opinionit që veprimet e Komisionerit Publik Saraçi kanë rrezikuar dhe vazhdojnë të rrezikojnë funksionimin e procesit të rivlerësimit (vetting process) në tërësi dhe cilësohen si veprime që justifikojnë hetim disiplinor në kuadër të nenit 16(4), 16(5), 16(7) dhe 16(8) të Ligjit 84/2016.”

Për të provuar pretendimet e mësipërme, vëzhguesit ndërkombëtarë, kërkesës për fillimin e hetimit disiplinor i kanë bashkëlidhur provat e mëposhtme:

1. Shkresë datë 11.01.2018 e Komisionerit Publik Ballhysa për vëzhguesin ndërkombëtar, së cilës i bashkëlidhet e-mail-i i z. Ballhysa për ONM-në dhe z. Saraçi, datë 22.11.2017; Procesverbal i mbledhjes së Komitetit *ad hoc*, datë 05.01.2018 dhe lista e kandidatëve e datës 05.01.2018; kopje e projektregullores;
2. Shkresë e ONM-së datë 10.01.2018 drejtuar të dy Komisionerëve Publikë lidhur me miratimin Rregullores së Institucionit të Komisionerit Publik;
3. E-mail i datës 08.01.2018 nga z. Ballhysa për vëzhguesin ndërkombëtar (VN), bashkëlidhur së cilit janë minutat e takimit të mbledhjes së Komisionerëve Publikë për miratimin e rregullores;
4. E-mail i datë 06.12.2017 nga VN për z. Saraçi dhe z. Ballhysa;
5. E-mail i datë 23.11.2017 i z. Ballhysa për z. Saraçi;
6. E-mail i datë 06.02.2018 nga z. Ballhysa për VN;

7. E-mail i datë 09.02.2018 nga z. Ballhysa për VN;”

Gjyqtari hetues Natasha Mulaj, në funksion të verifikimit të pretendimeve të mësipërme të vëzhguesve ndërkombëtarë ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, si më poshtë:

Më datë 19.02.2018 ka zhvilluar një takim me Komisionerin Publik nën hetim disiplinor Heral Saraçi. Në këtë takim gjyqtari hetues i ka shpjeguar Komisionerit Publik Saraçi, të drejtat procedurale në referencë të nenit 17, pika 7 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe konkretisht me të drejtën për t’u njohur me të gjitha aktet e çështjes, të drejtën për t’u dëgjuar, të paraqesë parashtrime si dhe të drejtën për t’u mbrojtur, duke e pyetur nëse donte të mbrohej me avokat.

Në këtë takim, Komisioneri Publik Saraçi i ka konfirmuar gjyqtarit hetues se ONM i kishte komunikuar atij kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor të datës 09.02.2018 si dhe dokumentacionin bashkëlidhur. Komisioneri Publik Saraçi i ka kërkuar gjyqtarit hetues t’i caktonte një afat për të përgatitur provat dhe për të parashtruar me shkrim argumentet mbrojtëse. Gjyqtari hetues i ka caktuar si afat të paraqitjes së parashtrimeve dhe të provave deri më datë 23.02.2018, ora 09:00, duke e paralajmëruar se në mungesë të tyre ajo nuk do të pengohej të përgatiste dhe paraqiste Raportin e hetimit pranë Komisionit Disiplinor.

Komisioneri Publik nën hetim Heral Saraçi ka rënë dakord për afatin e caktuar nga gjyqtari hetues për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim dhe provave.

Në datën 22.02.2018, me shkresën Nr. 28 Prot., Komisioneri Publik Saraçi i ka kërkuar gjyqtarit hetues, zgjatje të afatit për dorëzimin e parashtrimeve me shkrim, duke parashtruar arsyet se përse e kërkonte këtë shtyrje afati.

Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisionerit Publik Heral Saraçi, me shkresën Nr. 121 Prot., datë 22.02.2018 gjyqtari hetues i ka rikujtuar z. Saraçi, dakordësinë e tij për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim dhe provave më datë 23.02.2018 dhe nuk rezulton të jetë pranuar nga gjyqtari hetues shtyrja e këtij afati.

Në datën 23.02.2018, ora 09:00 Komisioneri Publik Heral Saraçi nuk u paraqit pranë gjyqtarit hetues pa e njoftuar atë për asnjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen. Njëkohësisht, Komisioneri Publik Saraçi nuk i paraqiti gjyqtarit hetues në afatin e caktuar, as parashtrime me shkrim dhe as prova. Seanca për dëgjimin dhe paraqitjen e parashtrimeve me shkrim dhe provave e datës 23.02.2018 nuk u shty nga gjyqtari hetues për një datë tjetër, pasi vlerësoi se:

1. *Kërkesa e zotit Saraçi për zgjatje afati nuk është bindëse si dhe sjellja e tij në lidhje me këtë kërkesë përbën një veprim, që në mënyrë të dukshme ka për qëllim të vonojë procedurën hetimore;*
2. *Koha e lënë në dispozicion të z. Saraçi ka qenë e mjaftueshme, duke marrë në konsideratë nevojën urgjente për kryerjen e procedimit disiplinor brenda një afati sa më të shpejtë, si dhe faktin që parashtrimet lidhen me veprimtarinë e vetë zotit Saraçi, për të cilat ai është në dijeni të plotë.*

3. *Provat e administruara nga ONM-ja ishin në dijëni nga z. Saraçi, sepse vetë ai është shprehur që nuk kërkon kohë për njohje pasi ka qenë në dijëni të plotë për aktet bashkëlidhur kërkesës.*
4. *Nga ecuria e procesit të hetimit disiplinor nuk paraqitet nevoja për marrjen nga Komisioneri Publik të informacioneve, dokumentave apo çdo prove tjetër që të jetë e nevojshme për hetimin; dhe se*
5. *Me këtë veprim nuk çënohet e drejta e Komisionerit Publik për t'u dëgjuar lidhur me procedimin disiplinor, në kuadër të garantimit të një procesi të rregullt duke qenë se ai gëzon të drejtën për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore nga Komisioni Disiplinor, ku mund të parashtrorjë qëndrimin e tij, jo vetëm ndaj kërkesës ankimore, por edhe ndaj provave të administruara, rezultateve të hetimit dhe rezultatit të mundshëm të procedurës.*

Sa më sipër rezulton e provuar nga Raporti i Hetimit të gjyqtarit hetues (faqe 8) si dhe nga procesverbali i mbajtur nga gjyqtari hetues i datës 23.02.2018.

Në kuadër të hetimit disiplinor, në funksion të veprimtarisë së subjektit nën hetim pranë Institucionit të Komisionerit Publik, gjyqtari hetues ka kërkuar pyetjen e Komisionerit tjetër Publik z. Ballhysa dhe gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit z. Daci, në cilësinë e tij si anëtar i Komitetit *ad hoc* pranë Institucionit të Komisionerit Publik, si persona që kanë dijëni për rrethanat e çështjes.

Në datën 21.02.2018, gjyqtari hetues ka marrë deklaratimet e Komisionerit Publik Florian Ballhysa, të cilat i ka dokumentuar në procesverbalin përkatës, i përbërë nga 9 (nëntë) fletë. Në shpjegimet e tij Komisioneri Publik Ballhysa ka parashtruar të gjithë historikun e komunikimit midis Komisionerëve Publike me njëri-tjetrin dhe Komisionerëve Publikë me vëzhguesit ndërkombëtarë, nga data 03.07.2017 deri në datën 08.01.2018, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar rolin dhe veprimet e secilit prej Komisionerëve Publikë në procesin e hartimit të projektregullores si dhe rolin dhe veprimtarinë e vëzhguesve ndërkombëtarë në këtë proces. Gjithashtu, Komisioneri Publik Ballhysa ka shpjeguar në mënyrë të detajuar rolin dhe veprimet e secilit prej Komisionerëve Publikë në procesin e rekrutimit të stafit të institucionit të Komisionerëve Publikë, si dhe rolin dhe veprimtarinë e vëzhguesve ndërkombëtarë në këtë proces. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, Komisioneri Publik Ballhysa ka dorëzuar pranë gjyqtarit hetues dokumentacionin provues, i cili është administruar nga gjyqtari hetues si pjesë e dosjes hetimore dhe është vlerësuar prej tij në Raportin e Hetimit.

Në datën 22.02.2018, gjyqtari hetues ka marrë deklaratimet e gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit Luan Daci në cilësinë e personit që ka dijëni për rrethanat e çështjes, për shkak të qenies së tij anëtar i Komitetit *ad hoc* të Institucionit të Komisionerit Publik. Gjyqtari Luan Daci ka shpjeguar rolin dhe veprimet e secilit prej Komisionerëve Publikë në procesin e rekrutimit të stafit të Institucionit të Komisionerëve Publikë, si dhe rolin dhe veprimtarinë e vëzhguesve ndërkombëtarë në këtë proces.



Three handwritten signatures in blue ink are visible at the bottom of the page. The first signature on the left is partially cut off. The middle signature is more legible and appears to be 'Luan Daci'. The signature on the right is also partially cut off.

Vëzhguesit ndërkombëtarë në kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor, lidhur me veprimtarinë e Komisionerit publik Heral Saraçi, në Komitetin *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, kanë parashtruar rrethanat e faktit si më poshtë:

“Lidhur me Komitetin *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Bazuar në nenin 18, pika të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” Komisionerit Publik Saraçi është anëtar i Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Dy anëtarët e tjerë të këtij Komiteti, gjyqtar Ina Rama dhe gjyqtar Luan Daci janë anëtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në sajë të shortit u bënë anëtarë të Komitetit *Ad Hoc* të këtij institucioni.

Në cilësinë e anëtarit të Komitetit *Ad Hoc*, Komisioneri Publik Saraçi mori pjesë në rekrutimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit të Apelimit dhe nuk shprehu asnjë kundërshti sa i takon përbërjes së Komitetit *ad hoc* për atë proces rekrutimi.

Pas emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm u iniciua procesi për rekrutimin e stafit ligjor të Kolegjit të Apelimit, sërish me Komisionerin Publik Saraçi si pjesë e Komitetit *Ad Hoc*.

Gjatë kësaj faze, Komisioneri Publik në mënyrë të përsëritur kërkoi kopje të dokumenteve të brendshme të Kolegjit të Apelimit, duke kundërshtuar për herë të parë bazën ligjore të caktimit të dy anëtarëve të Komitetit *ad hoc*.

Komisioneri Publik Saraçi, në mënyrë të përsëritur ka penguar procesin e rekrutimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Ai ose nuk është paraqitur në takime të caktuara, ose ka braktisur mbledhjet ku ka marrë pjesë pa u përmbushur objekti i takimit lidhur me procesin e rekrutimit. Në këto raste, ai nuk ka njoftuar dy anëtarët e tjerë lidhur me kthimin e mundshëm të tij, duke i lënë ata të presin për orë të tëra.

Komisioneri Publik Saraçi ka refuzuar të nënshkruajë procesverbalin e takimit edhe në rastet kur dy anëtarët e tjerë e kanë kërkuar me ngulm dhe e kanë ftuar atë të shtojë mendimin e tij personal në raport me zbatimin e dispozitave ligjore përkatëse.

Në 26.12.2017, Komisioneri Publik Saraçi i paraqiti dy anëtarëve të tjerë të Komitetit *Ad Hoc* një “Vendim” të njëanshëm, me anë të të cilit emëronte 7 këshilltarë ligjorë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke i lënë detyrë Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të zbatonte “Vendimin” e tij dhe duke e deklaruar këtë “Vendim”, me efekt të menjëhershëm.

Vëzhguesit ndërkombëtarë vënë re që, tre nga shtatë kandidatët e “emëruar” nga Komisioneri Publik Saraçi janë vlerësuar më parë si të pakualifikuar/ të papërshtatshëm nga Komiteti *Ad Hoc* për emërim në strukturat e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi ata nuk ishin përfshirë në short-listën e kandidatëve të vlerësuar, siç reflektohet në vendimin e Komitetit *Ad Hoc* të datës 26.12.2017. Si pasojë e mungesës së Komisionerit Publik Saraçi, procesi i vlerësimit të këshilltarëve ligjorë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit mundi të finalizohet vetëm nga dy anëtarët e tjerë të Komitetit *ad hoc* me shumicë, bazuar në vendimin e Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 13, datë 22.12.2017.

Gjatë procesit të vlerësimit të kandidatëve ligjorë, Komisioneri Publik Saraçi i dërgoi një letër Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, lidhur me problematikën e tij për këtë çështje, duke vënë në dijeni Kuvendin e Shqipërisë.

Me këtë veprim të tij, Komisioneri Publik Saraçi ka përfshirë politikën në mënyrë të papërshtatshme në funksionimin e brendshëm të institucioneve të rivlerësimit (vetting-ut), në vend që t'i diskutonte dhe t'i zgjidhte problemet e tij ligjore brenda mjedisit të duhur të institucioneve të vetting-ut.

Përsa më sipër, vëzhguesit ndërkombëtarë vendosën të intensifikojnë monitorimin e Komisionerit Publik Saraçi në Komitetin Ad Hoc pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe e informuan Komisionerin Publik Saraçi, verbalisht, për këtë vendim.

Vëzhgues të ndryshëm kanë konsumuar orë të gjata me Komitetin ad hoc të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit duke udhëzuar procesin e vlerësimit dhe short-listimit, për vendet e lira në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

Pavarësisht se Komisioneri Publik Saraçi ishte prezent në pjesën më të madhe të takimeve të Komitetit Ad Hoc të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjatë kësaj periudhe të monitorimit të intensifikuar nga vëzhguesit ndërkombëtarë, megjithatë ai ka munguar në të paktën një rast (shiko përmbledhjen e aktiviteteve të Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit) pa njoftim paraprak nga ana e tij.

Në 02.02.2018 Komiteti Ad Hoc i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit i bëri të qartë vëzhguesve ndërkombëtarë që mund të vijonin procesin pa prezencën e vëzhguesve në takimet e tyre.

Vëzhguesit ndërkombëtarë ranë dakord për këtë, dhe në vijim nuk morën pjesë në takimin e Komitetit ad hoc në datën 05.02.2018. Në takimin e Komitetit ad hoc të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ditën e hënë 05.02.2018 Komisioneri Publik Saraçi nuk ishte prezent, sërish pa njoftim apo shpjegim paraprak (shiko e-mailin e zj. Mulaj, Kryetare e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të datës 6 shkurt).

KPA-ja tentoi ta kontaktonte përmes e-mailit dhe telefonit celular.

Këto tentativa rezultuan të pasuksesshme pasi Komisioneri Publik Saraçi nuk reagoi dhe telefonin e tij celular e kishte të fikur.

Kolegjit i Posaçëm i Apelimit i dërgoi Komisionerit Publik Saraçi një shkresë zyrtare, ku njoftonte për takim të Komitetit ad hoc në datën 7 shkurt, ora 14:00 dhe u mundua ta dërgonte shkresën në adresën e përkohshme të institucionit të Komisionerëve Publikë në Rrugën e Kavajës, nëpërmjet korrierit.

Duke qenë se as Komisioneri Publik Saraçi, as kolegu i tij nuk ishin në zyrë në atë moment, korrieri i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit tentoi ta dërgonte shkresën tek Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, siç ka qenë proceduar më parë. Megjithatë, Komisioneri Publik Saraçi kishte udhëzuar stafin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të mos merrte asnjë dokument në emër dhe për llogari të tij.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit përfundimisht i dërgoi Komisionerit Publik Saraçi të njëjtën shkresë zyrtare nëpërmjet shërbimit postar. Komisioneri Publik Saraçi shfaqet në datën 7 shkurt, ora 14:00 në takimin e Komitetit Ad Hoc të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe kërkoi kohë shtesë për të rishikuar dosjet e të gjithë aplikantëve, ku dhe si për pasojë takimi u mbyll në orën 14:05 dhe u shty për në datën 8 shkurt, ora 12:00 (shiko procesverbalin).

Duke përmbledhur sa më sipër Komisioneri Publik Saraçi ka dështuar në ushtrimin e detyrave të tij si anëtar i Komitetit Ad Hoc të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ka dështuar të informojë kolegjet e tij në lidhje me vendndodhjen e tij, dhe ka dështuar të jetë i disponueshëm për kontakte normale, lidhur me çështjet e punës.”

Për faktet dhe pasojat e analizuara si më sipër, vëzhguesit ndërkombëtarë kanë arritur në konkluzionet si vijon:

“Me veprimet dhe mosveprimet e tij në mënyrë bashkëpunuese si më sipërpërshtuar, Komisioneri Publik Saraçi ka penguar procesin e rekrutimit të stafit ligjor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Fakti i thjeshtë i të pasurit një këndvështrim të ndryshëm në raport me ligjin nuk justifikon mungesë të përsëritur ose neglizhencë në ushtrimin e detyrës.

Veprimet e Komisionerit Publik Saraçi përbëjnë kërcënim për forcën vepruese të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe pozicionimin e tij në procesin e rivlerësimit (vetting process).

Vëzhguesit ndërkombëtarë nënshkrues janë të opinionit që këto veprime cilësohen si veprime që justifikojnë hetim disiplinor në kuadër të nenit 16(4), 16(5), 16(7) dhe 16(8) të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për të provuar pretendimet e mësipërme, vëzhguesit ndërkombëtarë, kërkesës për fillimin e hetimit disiplinor i kanë bashkëlidhur provat e mëposhtme:

1. Procesverbali i Komitetit ad hoc i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit datë 26, 21 dhe 22 dhjetor 2017;
2. Vendim nr. 13, datë 22.12.2017 i Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit;
3. Vendim i Komitetit Ad Hoc të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit datë 26.12.2017 “Për vlerësimin e kandidatëve për këshilltarë ligjorë”;
4. Vendim i Komisionerit Publik Heral Saraçi i datë 26.12.2017 “Për pranimin në punë të këshilltarëve ligjorë të Njësisë Ligjore të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”;
5. Korrespondencë midis Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe z. Saraçi dërguar për dijëni Kuvendit të Shqipërisë;
6. Shkresë e ONM-së, datë 10.01.2018, Nr. PC/03/2018 dërguar të dy Komisionerëve Publikë lidhur me dështimin për të rekrutuar stafin;
7. Shkresë e ONM e datë 09.01.2018, dërguar Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit mbi kërkesën për përcjelljen e dokumenteve që kanë të bëjnë me funksionimin e Komitetit Ad Hoc;
8. Përmbledhje e korrespondencës zyrtare midis zotit Saraçi dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Gjyqtari hetues Natasha Mulaj, në funksion të verifikimit të pretendimeve të mësipërme të Vëzhguesve Ndërkombëtarë ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, si më poshtë:

Në datën 21.02.2018 gjyqtari hetues ka marrë deklaratimet e gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit Ina Rama në cilësinë e personit që ka dijëni për rrethanat e çështjes, për shkak të qenies së saj anëtare e Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Në deklaratimet e saj, zj. Rama ka shpjeguar veprimet dhe mosveprimet e Komisionerit Publik Heral Saraçi në veprimtarinë e tij si anëtar i Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Në datën 22.02.2018, gjyqtari hetues ka marrë deklaratimet e gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit Luan Daci, në cilësinë e personit që ka dijëni për rrethanat e çështjes, për shkak të qenies së tij anëtar i Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Në deklaratimet e tij z. Daci ka

shpjeguar veprimet dhe mosveprimet e Komisionerit Publik Heral Saraçi në veprimtarinë e tij si anëtar i Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Gjyqtari hetues, në përfundim të veprimeve hetimore lidhur me faktet e parashtruara në kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor, pasi ka mbledhur dhe ka shqyrtuar të gjitha provat e nevojshme, të paraqitura së bashku me kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor nga vëzhguesit ndërkombëtarë, si dhe provave të krijuara gjatë veprimtarisë hetimore, ka hartuar Raportin e Hetimit, në të cilin ka përshkruar veprimtarinë hetimore, ka konfirmuar në mënyrë të qartë ekzistencën e fakteve mbi të cilat bazohet kërkesa për fillimin e hetimit disiplinor dhe ka arritur në konkluzionet e mëposhtme:

“Me cilësinë e gjyqtarës hetuese, unë Natasha Mulaj, përsa i përket kërkesës së paraqitur nga ONM-ja për fillimin e hetimit disiplinor ndaj Komisionerit Publik Heral Saraçi, e vlerësoj të drejtë, të mbështetur në ligj dhe në prova, përkatësisht në nenet C/16 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 16/4, 16/5, 16/7, 16/8 dhe 17 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe nga studimi i çështjes në tërësi konkludoj:

- *Me veprimet dhe mosveprimet e personit nën hetim Heral Saraçi është penguar veprimtaria siç duhet e institucionit të Komisionerit Publik, si institucion kyç në procesin e Rivlerësimit, si rrjedhojë kjo sjellje e tij në vazhdim paraqet rrezik në funksionimin e mëtejshëm të këtij Institucioni.*
- *Me veprimet dhe mosveprimet e tij si anëtar i Komitetit ad hoc pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ka penguar qëllimisht procesin e rekrutimit duke e zvarritur atë, pa shkaqe të arsyeshme.*
- *Qëndrimi i tij, jo i ekuilibruar në të gjitha komunikimet dhe sjelljet e tij përbën pengesë të zhvillimit të procesit në tërësi.*
- *Qëndrimi i tij jokorrekt përgjatë hetimit të merret si rrethanë rënduese nga Komisioni Disiplinor, në momentin e caktimit të masës disiplinore ndaj tij.”*

Pas depozitimit të Raportit të Hetimit pranë Komisionit Disiplinor, në datë 26.02.2018, Komisioni Disiplinor mori në shqyrtim këtë Raport Hetimor në seancat dëgjimore publike në datat 5, 7, 8 dhe 9 mars 2018.

Në seancën dëgjimore të datës 05.03.2018 Komisioneri Publik nën procedim disiplinor i paraqiti Komisionit Disiplinor tri kërkesa paraprake:

1. Zgjatjen e afatit tej datës 05.03.2018 për të depozituar shpjegimet e tij pranë Komisionit Disiplinor, me pretendimin se ndodhej në pamundësi kohore për të shqyrtuar një volum prej më tepër se 500 faqe dokumentacion. Kjo kërkesë bazohej në nenin 15 dhe 42 të Kushtetutës.

Komisioni Disiplinor, pasi e shqyrtoi këtë kërkesë konstatoi se ajo ishte e pabazuar, për arsye se aktet e procedimit disiplinor në pjesën dërrmuese të tyre ishin të njohura ose/dhe të hartuara nga vetë Komisioneri Publik Saraçi, para depozitimit të kërkesës për fillimin e hetimit disiplinor pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe për pasojë volumi i dokumenteve të krijuara gjatë hetimit disiplinor dhe që ishin të panjohura më parë prej tij, ishte i papërfillshëm (rreth 55 faqe) dhe për

pasojë, Komisioneri Publik Saraçi nuk kishte asnjë vështirësi reale për njohjen dhe vlerësimin e tyre. Kërkesa për fillimin e hetimit disiplinor dhe dokumentacioni bashkëlidhur saj i ishin vënë në dispozicion nga vëzhguesit ndërkombëtarë, Komisionerit Publik Saraçi menjëherë pas depozitimit të saj në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Ky fakt është pohuar nga z. Saraçi para gjyqtarit hetues, sipas procesverbalit të mbajtur në datën 19.02.2018. Ndërkohë që, aktet e dosjes hetimore të gjyqtarit hetues iu vunë në dispozicion në datë 27.02.2018, kohë e mjaftueshme kjo për t'u përgatitur për seancën dëgjimore të datës 05.03.2018. Sa më sipër, kjo kërkesë nuk u pranua nga Komisioni Disiplinor.

2. Shprehjen e Komisionit Disiplinor për juridiksionin dhe kompetencën për të shqyrtuar veprimtarinë institucionale të Komisionerëve Publikë (miratimin e rregullave, pjesëmarrjen e Komisionerit Publik më të vjetër në moshë në Komitetet *ad hoc* në institucionet e rivlerësimit (*vetting-out*) dhe rekrutimin e punonjësve në institucionin e Komisionerëve Publikë). Kjo kërkesë bazohej në nenin 23 të Kodit të Procedurave Administrative.

Komisioni Disiplinor, pasi e shqyrtoi këtë kërkesë konstatoi se ajo ishte e pabazuar, për arsye se juridiksioni dhe kompetenca e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e procedimit disiplinor bazohet plotësisht në nenin C, pika 16 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 17 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Sa më sipër, kjo kërkesë nuk u pranua nga Komisioni Disiplinor.

3. Thirrjen e Kuvendit të Shqipërisë për të marrë pjesë në seancën dëgjimore si palë me interes legjitim të drejtpërdrejtë në këtë procedurë administrative. Kjo kërkesë bazohej në nenin 3 dhe 33 të Kodit të Procedurave Administrative.

Komisioni Disiplinor, pasi e shqyrtoi këtë kërkesë konstatoi se ajo ishte e pabazuar, për arsye se Kushtetuta në nenin 179/b dhe nenin C të Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, garantojnë pavarësinë e institucioneve të rivlerësimit në kuadër të veprimtarisë së tyre funksionale. Sa më sipër, kjo kërkesë nuk u pranua nga Komisioni Disiplinor.

Në vazhdim të kërkesave procedurale në seancën dëgjimore të datës 05.03.2018, Komisioneri Publik Saraçi, pasi dëgjoi prezantimin e argumenteve të përmbledhura të Raportit të Hetimit kërkoi që mbrojtjen e mëtejshme të tij ta realizonte nëpërmjet një avokati dhe për këtë qëllim kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore për datën 08.03.2018. Komisioni Disiplinor, duke mbajtur në konsideratë afatin ligjor 15 ditor për shqyrtimin e procedimit disiplinor sipas nenit 17, pika 6 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranoi kërkesën për shtyrje dhe caktoi seancën e radhës në datë 07.03.2018.

Në seancën dëgjimore të datës 07.03.2018, Komisioneri Publik Saraçi nën procedim u paraqit së bashku me avokatin e zgjedhur prej tij, z. Shaqir Hasanaj.

Av. Hasanaj i kërkoi Komisionit Disiplinor që seanca dëgjimore të shtyhej në një datë tjetër, me pretendimin se koha në dispozicion të tij kishte qenë shumë e shkurtër, për shkak se ishte kontraktuar nga z. Saraçi vetëm në orën 22.00 të datës 06.03.2018.

Kjo kërkesë nuk u pranua nga Komisioni Disiplinor, pasi u vlerësua se Komisioneri Publik Saraçi i kishte patur të gjitha mundësitë objektive për të kontraktuar një avokat mbrojtës që nga momenti që kishte marrë dijeni për kërkesën e fillimit të hetimit disiplinor të datës 09.02.2018 dhe mosushtrimi i së drejtës së tij për zgjedhjen e një mbrojtësi në kohën e përshtatshme, nuk mund të konsiderohej si një shkak i arsyeshëm dhe i bazuar në ligj dhe që do të justifikohej të pengonte zhvillimin e procedimit disiplinor, brenda afatit 15 ditor të përcaktuar nga ligji.

Komisioneri Publik nën hetim Heral Saraçi, në funksion të mbrojtjes së tij, parashtrroi në seancë dëgjimore para Komisionit Disiplinor shpjegimet e tij në një dokument prej 24 (njëzetekatër) faqesh, në të cilin ka analizuar Raportin e Hetimit.

Në këto shpjegime Komisioneri Publik Saraçi, lidhur me veprimtarinë e tij në procesin e miratimit të rregullores së veprimtarisë së Institucionit të Komisionerëve Publikë, sipas kërkesës së nenit 69, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashtrroi se:

Institucioni i Komisionerëve Publikë nuk mundi të miratonte rregulloren e veprimtarisë së tij, brenda 30 ditëve nga krijimi i Institucionit. Ky afat përfundoi në datë 17.07.2017. Komisioneri Publik Saraçi shpjegoi veprimet e tij deri në këtë datë, në funksion të miratimit të rregullores dhe deklaroi se ka hartuar dokumentet: “Raport i Komisionerit Publik 17.06 – 16.07.2017” dhe “Përshkrim pune i Komisionerit Publik të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke e konsideruar të përmbushur detyrimin e tij ligjor, në zbatim të nenit 69, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioneri Publik Saraçi shpjegon se Komisioneri tjetër Publik Florian Ballhysa, deri në datë 17.07.2017 ka përgatitur dokumentin “Projekt/rregulla për veprimtarinë e Komisionerit Publik” dhe pranon se Mbledhja e Komisionerëve Publikë deri në datë 17.07.2017 nuk ka miratuar as aktet e hartuara nga Komisioneri Publik Saraçi dhe as projekt/rregullat e hartuara nga Komisioneri Publik Ballhysa.

Në vazhdim, Komisioneri Publik Saraçi përshkruan kronologjinë e komunikimeve me Komisionerin tjetër Publik Ballhysa dhe vëzhguesve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, në datat 20.07.2017; 24.07.2017; 27.07.2017; 23.08.2017; 31.08.2017; 3.11.2017; 9.11.2017; 13.11.2017; 17.11.2017; 20.11.2017; 21.11.2017; 24.11.2017; 29.11.2017; 5.12.2017; 6.12.2017; 4.01.2018; 8.01.2018. Për këto komunikime Komisioneri Publik Saraçi i kërkoi Komisionit Disiplinor të merren si prova *e-mail*-et e komunikimit midis Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë si dhe dokumentet bashkëlidhur këtyre *e-mail*-ve, të cilat u administruan si prova nga Komisioni Disiplinor.

Nëpërmjet këtyre komunikimeve Komisioneri Publik Saraçi shpjegon rolin e tij në procesin e hartimit të rregullores nga data 17.07.2017 kur kishte përfunduar afati ligjor për miratimin e saj deri në datën 08.01.2018, kur përfundoi afati i kërkuar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit për miratimin e rregullores.

Në shpjegimet e tij Komisioneri Publik Saraçi thekson se, çështjet kryesore për të cilat ai nuk ka rënë dakord me Komisionerin tjetër Publik dhe me rekomandimet e vëzhguesve ndërkombëtarë lidhen me kompetencat e Mbledhjes së Komisionerëve Publikë dhe kompetencat e Komitetit *ad hoc* për pranimin në punë pranë Institucionit të Komisionerit Publik, duke ripohuar se, edhe gjatë procedimit disiplinor ai mban qëndrim të pandryshuar për çështjet sa më sipër.

Lidhur me veprimtarinë e tij në procesin e rekrutimit të punonjësve të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në shpjegimet e tij Komisioneri Publik Saraçi, parashtroi se:

Rekrutimi i punonjësve të institucionit të Komisionerëve Publikë ka filluar pa u miratuar rregullorja e veprimtarisë së institucionit të Komisionerëve Publikë dhe deri në përfundim të hetimit disiplinor në institucionin e Komisionerëve Publikë janë pranuar në punë 4 këshilltarë ligjorë dhe 2 këshilltarë ekonomikë të Njesisë së Shërbimit Ligjor si dhe Kancelari. Këto pranime janë bërë me Vendimin nr. 1, datë 22.01.2018; Vendimin nr. 2, datë 30.01.2018 dhe Vendimin nr. 3, datë 08.02.2018 të Komitetit *ad hoc* të institucionit të Komisionerëve Publikë (të cilat Komisioneri Publik Saraçi kërkoi të merren si prova).

Në këto vendime është përcaktuar se të drejtat administrative të punonjësve të rekrutuar fillojnë me nënshkrimin e kontratës individuale të punës. Komisioneri Publik Saraçi shpjegoi se, fillimisht, ai i ka propozuar në datë 29.02.2018 Komisionerit tjetër Publik, projektin e një Urdhri të përbashkët të dy Komisionerëve Publikë për emërimin e këshilltarëve, nëpërmjet të cilit ngarkohej Kancelari për zbatimin e tij (Komisioneri Publik Saraçi kërkoi që projekti i këtij urdhri të merrej si provë). Ky urdhër është diskutuar midis dy Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe në përfundim të diskutimit, Komisioneri Publik Saraçi është tërhequr nga propozimi i tij.

Komisioneri Publik Saraçi shpjegoi se midis tij, Komisionerit tjetër Publik Florian Ballhysa dhe vëzhguesve ndërkombëtarë ka patur komunikime dhe diskutime, lidhur me përmbajtjen e kontratave individuale të punës. Komisioneri Publik Saraçi shpjegon se, fillimisht, drafti i kontratave të punës i është prezantuar atij nga Komisioneri tjetër Publik Ballhysa në datë 01.02.2018 dhe më pas Komisioneri Publik Saraçi ka propozuar disa ndryshime, të cilat janë pranuar nga Komisioneri Publik Ballhysa, përveç dy ndryshimeve që kishin të bënin me zgjatjen e periudhës së provës më shumë se tre muaj dhe me përfshirjen e Komitetit *ad hoc* në kontratat e punës. Në këto kushte janë zhvilluar diskutime të gjata midis Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe si pasojë e këtyre diskutimeve, Komisioneri Publik Saraçi është tërhequr vetëm nga propozimi i tij për zgjatjen e kohës së provës mbi tre muaj në kontratat e punës. Në vijim, Komisioneri Publik Saraçi ka pretenduar se në zbatim të vendimeve të sipërcituara të Komitetit *ad hoc*, ka nënshkruar dy kontrata pune me dy punonjës (të cilat ai kërkoi të merren si prova) dhe i ka kërkuar Komisionerit tjetër Ballhysa që t'i firmosë këto kontrata, por një gjë e tillë nuk është pranuar nga Komisioneri Publik Ballhysa.

Lidhur me veprimtarinë e tij në Komitetin *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Komisioneri Publik Saraçi parashtroi se:

Komisioneri Publik Saraçi ka ndërprerë veprimtarinë e tij si anëtar i këtij Komiteti *ad hoc* vetëm në datat 05.02.2018 dhe 06.02.2018 për arsye pamundësie shëndetësore dhe kërkoi marrjen si provë të një raporti mjekësor, të lëshuar nga mjeku, të datës 05.02.2018.

Komisioneri Publik Saraçi shpjegoi se, e gjithë veprimtaria e tij si anëtar i Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është bazuar në nenin 18, pika 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Veprimtaria e tij si anëtar i Komitetit *ad hoc* për përzgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me vendimin e datës 11.10.2017, si dhe veprimtaria për rekrutimin e 4 pozicioneve për specialist, e zhvilluar ndërmjet datave 17 nëntor deri 21 nëntor 2017, ka vijuar normalisht dhe procesverbalet e mbajtura nga Komiteti *ad hoc* janë nënshkruar nga të tre anëtarët e tij. Për të provuar sa më sipër, Komisioneri Publik Saraçi kërkoi marrjen si provë të akteve për zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit si dhe të veprimtarisë së Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për rekrutimin e 4 specialistëve në datat 17 nëntor deri në 21.11.2017.

Komisioneri Publik Saraçi pretendon se mosdakordësia e tij me dy anëtarët e tjerë të Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ka filluar më datë 16.12.2017, datë në të cilën Komiteti *ad hoc*, nëpërmjet miratimit të një projektvendimi për vlerësimin e kandidatëve, i cili do të përmblihte punën e bërë deri në atë datë për shqyrtimin e kandidatëve për këshilltarë ligjorë. Shkak i mosdakordësisë me dy anëtarët e tjerë të Komitetit *ad hoc* është bërë fakti se në bazën ligjore të këtij projektvendimi nuk ishte vendosur neni 18, pika 4 i ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Sipas Komisioneri Publik Saraçi, vetëm neni 18, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” e legjitimonte atë si anëtar të Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Në këto rrethana ka filluar një komunikim shkresor midis Komisionerit Publik Saraçi dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si më poshtë:

1. Kërkesë e datës 17.12.2017 për vënien në dispozicion të akteve që pasqyrojnë punën e Komisionerit Publik Saraçi si anëtar i Komitetit *ad hoc*;
2. Kërkesë e datës 17.12.2017 për vënien në dispozicion të aktit të brendshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që përcakton emrat e dy anëtarëve të Komitetit *ad hoc*, të zgjedhur me short nga radhët e anëtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit;
3. Shkresë e datës 17.12.2017 me lëndë: “Propozim i rendit të ditës të mbledhjes së Komitetit *ad hoc*”;
4. Shkresë e datës 17.12.2017 me lëndë: “Kërkohet anulimi i “Regullore për veprimtarinë e Komitetit *ad hoc* për administrimin e procesit të emërimeve në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, datë 06.11.2017” (kjo shkresë i është dërguar për dijeni Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit).

Në përgjigje të këtyre shkresave, Kolegji i Posaçëm i Apelimit me shkresën Nr. 29/1 Prot. ka përcjellë në drejtim të Komisionerit Publik Saraçi, dokumentacion që lidhet me veprimtarinë e tij si anëtar i Komitetit *ad hoc*. Në përgjigje të kësaj shkrese, Komisioneri Publik Saraçi i është

drejtuar përsëri Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me shkresën e datës 25.12.2017, në të cilën kërkon të plotësohet dokumentacioni i kërkuar prej tij me shkresat e datës 17.12.2017. Kjo shkresë i është dërguar për dijëni Kuvendit të Shqipërisë.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit me shkresën Nr. 34/1 Prot., datë 26.12.2017 i ka kthyer përgjigje shkresës së Komisionerit Publik të datës 25.12.2017. Kjo shkresë i është dërguar për dijëni Kuvendit të Shqipërisë. Të gjitha këto shkresa dhe dokumentacioni që i bashkëlidhej atyre u kërkuan nga Komisioneri Publik Saraçi të merreshin si prova, në seancën dëgjimore të procedimit disiplinor.

Komisioneri Publik Saraçi shpjegon se mosnënshkrimi i tij në vendimin e datës 26.12.2017 të Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit “Për vlerësimin e kandidatëve për këshilltarë ligjorë” është bërë për arsye se në bazën ligjore të tij nuk ishte përfshirë neni 18, pika 4 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe se ky fakt i mohonte atij të drejtën për vendimmarrje. Për këtë arsye, Komisioneri Publik Saraçi ka marrë vendimin, datë 26.12.2017 “Për pranimin në punë të këshilltarëve ligjorë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”.

Komisioneri Publik Saraçi pretendon se, për shkak të mospasjes së një qasjeje të përbashkët me anëtarët e tjerë të Komitetit *ad hoc*, ai nuk ka nënshkruar procesverbale dhe ka dhënë vendime individuale, por kjo sjellje nuk mund të konsiderohet shkelje, bazuar në dispozitat ligjore. Komisioneri Publik Saraçi shpjegon se, ai nuk ka qenë dakord me zbatimin nga ana e tij të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese” dhe rregullores “Për veprimtarinë e Komitetit *ad hoc* për administrimin e procesit të emërimeve në Kolegjin e Apelimit”, për arsye se, sipas tij, kjo do të cenonte kompetencën e tij vendimmarrëse. Komisioneri Publik Saraçi pretendon se, ai nuk ka patur për qëllim t’i lërë dy anëtarët e tjerë të Komitetit *ad hoc* ta presin atë për disa orë, në datë 26.12.2017, por kjo ka ardhur si pasojë e nevojës për të formatuar në një kompjuter vendimin e tij. Ai pretendon se vendimi i tij i datës 26.12.2017 “Për pranimin në punë të këshilltarëve ligjorë të KPA-së” nuk është i njëanshëm, pasi ky vendim i është dërguar me postë dy anëtarëve të tjerë të Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit si dhe është depozituar personalisht prej tij në Komitetin *ad hoc* në datën 26.12.2017, ora 17.45.

Komisioneri Publik Saraçi shpjegon se veç vendimit të sipërcituar të datës 26.12.2017, ai ka shprehur vullnetin e tij si anëtar i Komitetit *ad hoc* për pranimin në punë të punonjësve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit edhe në 5 vendime të tjera:

Vendim nr. 1, datë 18.01.2018 “Për pranimin në punë të një specialisti IT”;

Vendim nr. 2, datë 18.01.2018 “Për pranimin në punë të një specialisti Arkiv/Protokolli”;

Vendim nr. 3, datë 18.01.2018 “Për pranimin në punë të një specialisti të burimeve njerëzore”;

Vendim nr. 4, datë 18.01.2018 “Për pranimin në punë të një specialisti financë/buxheti”;

Vendim nr. 5, datë 18.01.2018 “Për pranimin në punë të 3 (tre) këshilltarëve ekonomikë në Njësinë e Shërbimit Ligjor”.

Të gjitha këto vendime u kërkuan nga Komisioneri Publik Saraçi të merreshin si prova në seancën dëgjimore të procedimit disiplinor.

Komisioneri Publik Saraçi pretendon se, me paraqitjen e tij në mbledhjet e Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe me vendimet e tij për pranimin në punë të punonjësve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ai ka përmbushur detyrat e tij ligjore. Mosnënshkrimi prej tij i pesë procesverbaleve nuk shkel ndonjë akt të miratuar nga Komiteti *ad hoc*.

Komisioneri Publik Saraçi pohon se, në praninë e vëzhguesve ndërkombëtarë, nga data 25.01.2018 e në vazhdim është përfshirë në procesin e rekrutimit të punonjësve të administratës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke nënshkruar procesverbalet e mbledhjeve të Komitetit *ad hoc*. Ai vazhdon punën në atë Komitet duke shprehur mendimin e tij, qoftë edhe në pakicë.

Komisioneri Publik Saraçi pretendon se veprimtaria e tij si anëtar i Komitetit *ad hoc* pranë Institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka patur një ecuri mëse të kënaqshme.

III.

Komisioni Disiplinor, pasi mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike Raportin e Hetimit të gjyqtarit hetues dhe të gjitha provat bashkëlidhur, si dhe shqyrtoi të gjitha provat e paraqitura nga Komisioneri Publik nën hetim disiplinor Heral Saraçi, konstaton se:

Lidhur me veprimtarinë e Komisionerit Publik Heral Saraçi në kuadër të procesit të miratimit të Rregullores së veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit Publik në zbatim të nenit 69, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” rezultojnë të provuara faktet si më poshtë:

Institucioni i Komisionerëve Publikë, deri më sot nuk ka miratuar rregulloren (rregullat) për veprimtarinë e institucionit në zbatim të nenit 69, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky parashikim ligjor kërkonte që kjo rregullore të miratohej nga Mbledhja e Komisionerëve Publikë, brenda 30 ditëve nga dita e krijimit të këtij Institucioni. Afati i kërkuar nga ligji ka përfunduar në datë 17.07.2017. Deri në këtë datë, të vetmet akte të hartuara nga Komisioneri Publik Saraçi janë: “Raport i Komisionerit Publik 17.06.2017-16.07.2017” dhe “Përshkrim pune i Komisionerit Publik të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ndërkohë, Komisioneri tjetër Publik Ballhysa kishte hartuar aktin: “Projekt/rregulla për veprimtarinë e institucionit të Komisionerit Publik”.

Në vlerësimin e Komisionit Disiplinor, dy aktet e hartuara nga Komisioneri Publik Saraçi, si më sipër, nuk plotësojnë kërkesat e nenit 69 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi ato nuk parashikojnë rregulla për veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë. Në këto kushte, përfshirja reale e Komisionerit Publik Saraçi, në procesin e miratimit të rregullores bëhet vetëm pas datës 17.07.2017.

Në datën 20.07.2017 është zhvilluar takimi i parë midis Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë në lidhje me rregulloren. Në datën 24.07.2017, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i përcjell me shkrim dy Komisionerëve Publikë, opinionin për disa çështje thelbësore që lidhen me veprimtarinë e Institucionit. Në datën 27.07.2017 është zhvilluar takimi i radhës

midis dy Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe është rënë dakord që nevojitet një rregullore për veprimtarinë e Institucionit, sipas kërkesave të ligjit.

Në datë 31.08.2017, Komisioneri Publik Ballhysa i ka sjellë në vëmendje Komisionerit Publik Saraçi se ai vazhdon të jetë në pritje të komenteve të tij për “Projekt/rregulla për veprimtarinë e institucionit të Komisionerit Publik” e hartuar prej Komisionerit Publik Ballhysa, e cila i ishte përcjellë edhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Në datën 04.09.2017 Komisioneri Publik Ballhysa, në një komunikim me e-mail i rikujton Komisioneri Publik Saraçi se është ende në pritje të sugjerimeve të tij, në lidhje me projektregulloren.

Në datë 11.10.2017, nëpërmjet një *e-mail*-i drejtuar vëzhguesve ndërkombëtarë dhe për dijeni Komisionerit Publik Saraçi, Komisioneri Publik Ballhysa kërkon realizimin e një takimi të përbashkët midis Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë lidhur me funksionimin e institucionit. Ky takim është realizuar në datë 17.10.2017 dhe në këtë takim është ritheksuar nevoja e vazhimit të punës për projektregulloren. Komisioneri Publik Ballhysa mori përsipër përditësimin e projektregullores së paraqitur prej tij në datë 17.07.2017, sipas opinionit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Deri në këtë datë, Komisioneri Publik Saraçi nuk kishte dhënë asnjë kontribut për hartimin e rregullores.

Në datë 03.11.2017, Komisioneri Publik Ballhysa i ka dërguar Komisionerit Publik Saraçi projektregulloren e përditësuar, duke ia përcjellë për dijeni edhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Në datë 13.11.2017, Komisioneri Publik Saraçi i ka përcjellë Komisionerit Publik Ballhysa dhe vëzhguesve ndërkombëtarë propozimet e tij, në gjuhën shqipe dhe në datë 17.11.2017 këto propozime i ka përcjellë edhe në gjuhën angleze.

Në datë 20.11.2017, Komisioneri Publik Ballhysa, pasi ka shqyrtuar propozimet e Komisionerit Publik Saraçi ka përgatitur një version të konsoliduar të projektregullores, të cilin ia ka përcjellë Komisioneri Publik Saraçi dhe vëzhguesve ndërkombëtarë.

Në datën 21.11.2017 është zhvilluar takimi i radhës i Komisionerëve Publikë me vëzhguesit ndërkombëtarë. Në këtë takim është rënë dakord për të gjitha çështjet për të cilat Komisionerët Publikë kishin qëndrime të ndryshme, me përjashtim të çështjes që lidhej me kompetencën e Mbledhjes së Komisionerëve Publikë për rekrutimin e stafit.

Në datë 22.11.2017 Komisioneri Publik Ballhysa i ka dërguar Komisionerit Publik Saraçi dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, variantin e konsoliduar të projektregullores, duke treguar nenet për të cilat nuk është arritur një marrëveshje dhe sqaron se të gjitha ato lidhen me kompetencën e Mbledhjes së Komisionerëve Publikë për të vendosur për rekrutimin e stafit.

Në datë 24.11.2017, nëpërmjet *e-mail*-it, Komisioneri Publik Ballhysa i ka sjellë në vëmendje Komisionerit Publik Saraçi nevojën e miratimit të rregullores, pasi prej saj varej edhe procesi i rekrutimit të personelit dhe e ka ftuar të takohen për të diskutuar në datë 30.11.2017, ora 8.30.

Në përgjigje të këtij *e-mail*-i, Komisioneri Publik Saraçi i ka dërguar një *e-mail* Komisionerit Ballhysa në datën 29.11.2017, ku i parashton këndvështrimin e tij për mënyrën e organizimit të Mbledhjes së Komisionerëve Publikë, por nuk paraqet asnjë propozim konkret për mënyrën sesi Komisionerët do të avancojnë më tej me miratimin e projektregullores. Komisioneri Publik Saraçi mban qëndrimin se ligji nuk i jep Komisionerëve Publikë, kompetencë për të thirrur Mbledhjen e Komisionerëve, për çështjen e miratimit të rregullores.

Në datë 06.12.2017, vëzhguesit ndërkombëtarë i kanë përcjellë të dy Komisionerëve Publikë, opinionin e shprehur edhe në takimet e mëparshme lidhur me kompetencat e Komitetit *ad hoc* dhe Mbledhjes së Komisionerëve Publikë përsa i takon procesit të rekrutimit të stafit, por duke i sjellë në vëmendje se në çdo rast rekrutimi i stafit duhet të bëhet me konsensusin e të dy Komisionerëve. Vëzhguesit kanë sqaruar se ky opinionon lidhet me çështjen e vetme të mbetur pazgjidhur në lidhje me miratimin e rregullores.

Në datë 04.01.2018 është zhvilluar takimi i radhës ndërmjet dy Komisionerëve dhe vëzhguesve ndërkombëtarë. Në këtë takim është ritrajtuar çështja e mosmiratimit të Rregullores dhe në përfundim të tij, vëzhguesit ndërkombëtarë shprehën pritshmërinë e tyre lidhur me arritjen e dakordësisë mes dy Komisionerëve, për miratimin e rregullores, deri më datë 08.01.2018.

Për këtë qëllim, në datë 05.01.2018, Komisioneri Publik Ballhysa i ka propozuar Komisionerit Publik Saraçi të miratojnë rregulloren e institucionit në datën 08.01.2018, në prani të vëzhguesve ndërkombëtarë në respekt të kontributit të tyre, duke i sjellë në vëmendje se opinionin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit lidhur me kompetencat e Mbledhjes së Komisionerëve Publikë në rekrutimin e stafit kishte zgjidhur përfundimisht të gjitha çështjet e mbetura pezull si dhe i rivë në dukje vonesën prej 6 muajsh në miratimin e rregullores së institucionit.

Në datën 08.01.2018, në orën 08.29 Komisioneri Publik Saraçi i përcjell me *e-mail* Komisionerit Publik Ballhysa dhe për dijeni vëzhguesve ndërkombëtarë, një projektregullore. Komisioneri Publik Ballhysa në përgjigje të këtij *e-mail*-i, po në datë 08.01.2018, ora 09.25 ka nisur në drejtim të Komisionerit Publik Saraçi dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, një *e-mail*, në të cilin konstaton se projektregullorja e sjellë nga Komisioneri Publik Saraçi është një version i ri i projektregullores, pasi vihet re se në tekstin e saj ka ndryshime thelbësore, të cilat nuk reflektonin çështjet e zgjidhura më parë me marrëveshje midis Komisionerëve Publikë dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Në këto kushte, në takimin e orës 11.00, të datës 08.01.2018 Komisionerët Publikë u paraqitën me projekte të ndryshme dhe asnjëri nga projektet e rregulloreve nuk u nënshkrua. Në takim vëzhguesit ndërkombëtarë theksuan se kjo situatë duhej të zgjidhej, nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje dhe duhej të njoftohej Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit lidhur me rezultatin, jo më vonë se ora 16.00 e së njëjtës date. Po në datë 08.01.2018, ora 15.14, Komisioneri Publik Ballhysa e ka ftuar Komisionerin Publik Saraçi të nënshkruajnë rregulloren brenda orës 16.00 (afatit të kërkuar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit) në variantin e diskutuar dhe finalizuar përgjatë disa muajve edhe me mbështetjen e vëzhguesve ndërkombëtarë. Komisioneri Publik Ballhysa i është drejtuar Komisionerit Publik Saraçi duke i thënë: “*Ju duhet të kuptoni që është e pamundur të fillojmë sërish diskutimet mbi një version të ri, siç është dokumenti që ju dërguat sot me e-mail. Është humbur shumë kohë me këtë çështje, madje edhe sot. Në orën 16.00 ju ftoj të nënshkruajmë rregulloren dhe të njoftojmë vëzhguesit ndërkombëtarë*”. Në përgjigje të këtij *e-mail*-i në orën 15.55, po të kësaj date Komisioneri Publik Saraçi është përgjigjur se: “*Unë*

ndodhem në zyrë dhe jam gati të nënshkruaj draftregulloren që ju kam përcjellë me e-mail sot". Pas këtyre komunikimeve secili prej Komisionerëve Publikë ka nënshkruar dhe ka depozituar pranë vëzhguesve ndërkombëtarë, variantin e vet të rregullores.

Në analizë të sa mësipër, Komisioni Disiplinor arrin në konkluzionin se Komisioneri Publik nën procedim disiplinor Heral Saraçi, deri në datën 17.07.2017 kur përfundonte afati ligjor i përcaktuar nga neni 69, pika 3 i ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nuk ka hartuar ndonjë projektregullore për veprimtarinë e institucionit, por ka hartuar vetëm akte që nuk mund të konsiderohen rregulla për veprimtarinë e tij.

Nga data 17.07.2017 deri në datë 13.11.2017, Komisioneri Publik Saraçi nuk ka dhënë asnjë kontribut në procesin e hartimit të rregullores. Në datë 13.11.2017, Komisioneri Publik Saraçi ka dhënë për herë të parë propozimet e tij mbi projektregulloren që deri në këtë moment është hartuar vetëm nga Komisioneri tjetër Publik Ballhysa. Pas kësaj date, Komisioneri Publik Saraçi nuk ka bashkëpunuar për hartimin e rregullores, megjithëse në datën 06.12.2017 Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit kishte dhënë opinionin e tij përfundimtar për çështjen e vetme të mbetur në diskutim dhe nuk kishte më asnjë pengesë objektive për miratimin e një rregulloreje përfundimtare. Në datën 08.01.2018, kur pritej finalizimi i procesit të rregullores, nëpërmjet nënshkrimit të një projekti të vetëm të dakordësuar edhe me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, Komisioneri Publik Saraçi paraqiti një projekt të ri, i cili nuk respektonte marrëveshjet e arritura midis Komisionerëve Publikë dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dhe kushtëzoi miratimin e rregullores vetëm me nënshkrimin e versionit të tij. Në këto kushte, Komisioneri Publik Saraçi duke shfaqur mungesën e vullnetit të sinqertë për të bashkëpunuar, me veprimet dhe mosveprimet e tij ka dëmtuar rëndë funksionimin normal të institucionit të Komisionerëve Publikë, duke rrezikuar efikasitetin e veprimtarisë së tij në mbrojtjen e interesit publik dhe për pasojë edhe të vetë procesit të rivlerësimit (*vetting process*) në përgjithësi. Nëpërmjet këtyre veprimeve dhe mosveprimeve ka vonuar dhe zvarritur në mënyrë të përsëritur dhe të pajustificuar miratimin e rregullores së veprimtarisë së Institucionit dhe për më tepër, në mënyrë të pajustificuar, të qëllimshme dhe të përsëritur nuk ka përmbushur funksionet e tij dhe për këtë arsye duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore në kuptim të nenit 16, pika 5 dhe pika 8 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Lidhur me veprimtarinë e Komisionerit Publik Heral Saraçi në kuadër të procesit rekrutimit të stafit të Komisionerit Publik rezultojnë të provuara faktet si më poshtë:

Procesi i rekrutimit të stafit të Institucionit të Komisionerëve Publikë është bërë nëpërmjet Komitetit *ad hoc* të përbërë nga dy Komisionerët Publikë dhe anëtari më i vjetër në moshë i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Në datën 05.01.2018 Komiteti *ad hoc* ka filluar punën për rekrutimin e këshilltarëve ligjorë të Njesisë së Shërbimit Ligjor. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve, anëtarët e këtij Komiteti, z. Ballhysa dhe z. Daci kanë hartuar dhe nënshkruar më datë 05.01.2018, një procesverbal të Komitetit *ad hoc* për vlerësimin e kandidaturave për këshilltarë ligjorë, duke bashkëlidhur tabelat përkatëse të kandidatëve që plotësonin kriteret formale ligjore dhe të

kandidatëve që nuk plotësonin kriteret formale ligjore. Komisioneri Publik Saraçi nuk i ka nënshkruar procesverbalin dhe tabelat bashkëlidhur, megjithëse ishte i pranishëm në mbledhje. Në këto kushte, procesi i rekrutimit të stafit në Institucionin e Komisionerëve Publikë filloi pa konsensus midis dy Komisionerëve Publikë dhe duke mosrespektuar opinionin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit të datës 06.12.2017, i cili iu kërkonte që procesi të bëhej me mirëkuptimin e dy Komisionerëve. Nisur nga kjo sjellje e Komisionerit Publik Saraçi, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit në kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor ka shpjeguar se në përpjekje për të lehtësuar procesin e rekrutimit të stafit në Institucionin e Komisionerit Publik, duke filluar nga janari 2018, vendosi që vëzhguesit ndërkombëtarë të intensifikonin monitorimin e performancës së Komisionerit Publik Saraçi në Institucionin e Komisionerëve Publikë, duke e njoftuar Komisionerin Publik Saraçi për këtë vendim. Nën monitorimin e vëzhguesve ndërkombëtarë, Komiteti *ad hoc* vendosi me vendimin nr. 1, datë 22.01.2018 pranimin në punë të 4 këshilltarëve ligjorë dhe me vendimin nr. 2, datë 30.01.2018 vendosi pranimin në punë të 2 këshilltarëve ekonomikë.

Në këto vendime është përcaktuar se të drejtat administrative të punonjësve të rekrutuar fillojnë me nënshkrimin e kontratës individuale të punës. Komisioneri Publik Saraçi i ka propozuar në datë 29.01.2018 Komisionerit tjetër Publik, projektin e një Urdhri të përbashkët të dy Komisionerëve Publikë për emërimin e këshilltarëve, nëpërmjet të cilit ngarkohej Kancelari për zbatimin e tij.

Në datë 01.02.2018 Komisioneri Publik Ballhysa i ka dërguar Komisionerit Publik Saraçi një draft të kontratës individuale të punës. Projekturdhri i propozuar nga Komisioneri Publik Saraçi dhe drafti i kontratës së punës i propozuar nga Komisionerit Publik Ballhysa janë diskutuar me vëzhguesit ndërkombëtarë, në takimin e datës 02.02.2018. Në këtë takim, Komisioneri Publik Saraçi është tërhequr nga propozimi i tij i projekturdhrit dhe është rënë dakord që kontratat individuale të punës me këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë do të lidheshin më datë 05.02.2018.

Në datat 05.02.2018 dhe 06.02.2018 Komisioneri Publik Saraçi nuk është paraqitur në punë për shkaqe shëndetësore, por nuk e njoftoi Komisionerin tjetër Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtarë për këtë situatë. Kjo sjellje e Komisionerit Publik Saraçi është e papranueshme, pasi ai i kishte të gjitha mundësitë objektive për të njoftuar Komisionerin tjetër Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtarë për pamundësinë e tij për të realizuar detyrimet e marra përsipër, për nënshkrimin e kontratave individuale të punës me stafin e Institucionit.

Komisioneri Publik Saraçi në datën 07.02.2018 ka propozuar disa ndryshime në kontratat individuale të punës, të cilat janë pranuar nga Komisioneri Publik Ballhysa, përveç dy ndryshimeve që kishin të bënin me zgjatjen e periudhës së provës më shumë se tre muaj dhe me përfshirjen e Komitetit *ad hoc* në kontratat e punës.

Në këto kushte, në datë 08.02.2018 janë zhvilluar diskutime të gjata midis Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, të cilët kanë konstatuar se propozimet e Komisionerit Publik Saraçi vinin në kundërshtim me ligjin.

Në datë 19.02.2018, Komisioneri Publik Saraçi ka nënshkruar dy kontrata pune me dy punonjës pa dijeninë dhe praninë e Komisionerit Publik Ballhysa.

Në datë 20.02.2018, Komisioneri Publik Saraçi, nëpërmjet një shkrese të dërguar me postë i ka kërkuar Komisionerit tjetër Ballhysa që t'i firmosë këto kontrata, por një gjë e tillë nuk është pranuar nga Komisioneri Publik Ballhysa, për shkak se ato përmbanin një nga dy parashikimet ligjore të kundërshtuara nga Komisionerit Publik Ballhysa dhe vëzhguesit ndërkombëtarë dhe konkretisht neni 19 sipas të cilit: “Çështjet objekt të kësaj kontrate për të cilat Komisionerët Publikë punëdhënës nuk mirëkuptohen shqyrtohen dhe vendosen nga Komiteti ad hoc, pranë institucionit të Komisionerëve Publikë, i konstituuar në bazë të pikës 4 të nenit 18 të ligjit nr. 84/2016”.

Për situatën e mësipërme, Komisioneri Publik Ballhysa në datë 19.02.2018 ka njoftuar vëzhguesit ndërkombëtarë, të cilët me shkresën Nr. AC/22/2018, datë 20.02.2018 kanë përcjellë këtë fakt tek gjyqtari hetues, i cili po zhvillonte veprimet hetimore, për t'i konsideruar në veprimtarinë e tij hetimore.

Aktualisht, asnjë nga punonjësit e pranuar në punë në Institucionin e Komisionerëve Publikë nuk ka një kontratë individuale pune të nënshkruar në mënyrë të rregullt nga të dy Komisionerët, megjithëse paraqiten rregullisht në institucion dhe kanë shkëputur marrëdhëniet e tyre të punës me punëdhënësit e tyre të mëparshëm.

Komisioni Disiplinor, në analizë të sa mësipër arrin në konkluzionin se me veprimet e mosveprimet e tij Komisioneri Publik Saraçi, gjatë ushtrimit të funksionit ka shkaktuar vonesë dhe zvarritje të përsëritur dhe të pajustificuar të procesit të rekrutimit të stafit, duke shkaktuar kaos, pasiguri të punëmarrësve në marrëdhënien e tyre të punës me Institucionin e Komisionerëve Publikë dhe për pasojë ka dëmtuar rëndë funksionimin normal të këtij Institucioni, duke rrezikuar efencën e veprimtarisë së tij në mbrojtjen e interesit publik dhe për pasojë edhe të vetë procesit të rivlerësimit (*vetting process*) në përgjithësi. Për më tepër, në mënyrë të pajustificuar, të qëllimshme dhe të përsëritur nuk ka përmbushur funksionet e tij dhe për këtë arsye duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore në kuptim të nenit 16, pika 5 dhe pika 8 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Lidhur me veprimtarinë e Komisionerit Publik Heral Saraçi si anëtar i Komitetit *ad hoc* pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit rezultojnë të provuara faktet si më poshtë:

Komisioneri Publik Saraçi ka filluar veprimtarinë e tij si anëtar i Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, së bashku me dy anëtarët e tjerë të tij gjyqtarët Ina Rama dhe Luan Daci, në procesin e përzgjedhjes së Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit, me vendimin e datës 11.10.2017 dhe ka vazhduar me veprimtarinë për rekrutimin e 4 pozicioneve për specialist, të zhvilluara ndërmjet datave 17 deri 22 Nëntor 2017. Në këto procese, veprimtaria e tij është dokumentuar në procesverbalet e mbajtura nga Komiteti *ad hoc*, të cilat janë nënshkruar nga të tre anëtarët e tij.

Mosdakordësia e Komisionerit Publik Saraçi me dy anëtarët e tjerë të Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ka filluar më datë 16.12.2017, datë në të cilën Komiteti *ad hoc*, në kuadër të procesit të rekrutimit të këshilltarëve ligjorë, nëpërmjet miratimit të një projektvendimi për vlerësimin e kandidatëve, do të përmblihte punën e bërë deri në atë datë për shqyrtimin e këtyre kandidatëve. Shkak i mosdakordësisë me dy anëtarët e tjerë të Komitetit *ad hoc* është bërë fakti se në bazën ligjore të këtij projektvendimi nuk ishte vendosur neni 18, pika 4 i ligjit nr. 84/2016 “Për

rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Komisioneri Publik Saraçi pretendonte se vetëm neni 18, pika 4 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” e legjitimonte atë si anëtar të Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Në këto rrethana ka ndërprerë bashkëpunimin e tij me dy anëtarët e tjerë të Komitetit *ad hoc* dhe ka filluar një komunikim shkresor me Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, si më poshtë:

1. Kërkesë e datës 17.12.2017 për vënien në dispozicion të akteve që pasqyrojnë punën e Komisionerit Publik Saraçi si anëtar i Komitetit *ad hoc*;
2. Kërkesë e datës 17.12.2017 për vënien në dispozicion të aktit të brendshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit që përcakton emrat e dy anëtarëve të Komitetit *ad hoc*, të zgjedhur me short nga radhët e anëtarëve të Kolegjit;
3. Shkresë e datës 17.12.2017 me lëndë: “Propozim i rendit të ditës të mbledhjes së Komitetit *ad hoc*”;
4. Shkresë e datës 17.12.2017 me lëndë: “Kërkohej anulimi i “Regullore për veprimtarinë e Komitetit *ad hoc* për administrimin e procesit të emërimeve në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, datë 06.11.2017” (kjo shkresë i është dërguar për dijeni Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit).

Në përgjigje të këtyre shkresave, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën Nr. 29/1 Prot. ka përcjellë në drejtim të Komisionerit Publik Saraçi, dokumentacion që lidhet me veprimtarinë e tij si anëtar i Komitetit *ad hoc*. Në përgjigje të kësaj shkrese, Komisioneri Publik Saraçi i është drejtuar përsëri Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me shkresën e datës 25.12.2017, në të cilën kërkon të plotësohet dokumentacioni i kërkuar prej tij me shkresat e datës 17.12.2017. Kjo shkresë i është dërguar për dijeni Kuvendit të Shqipërisë.

Komisioni Disiplinor vlerëson se me dërgimin e shkresës së mësipërme, për dijeni Kuvendit të Shqipërisë, Komisioneri Publik Saraçi ka tentuar të përfshijë në mënyrë të papërshtatshme politiken në funksionimin e brendshëm të institucioneve kushtetuese të pavarura të rivlerësimit (*Vetting-ut*), në vend që zgjidhjet për problemet e tij t'i kërkonte brenda mjedisit të duhur të institucioneve dhe procesit të rivlerësimit.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën Nr. 34/1 Prot., datë 26.12.2017 i ka kthyer përgjigje shkresës së Komisionerit Publik të datës 25.12.2017. Kjo shkresë i është dërguar për dijeni Kuvendit të Shqipërisë. Me këtë shkresë Kolegji i Posaçëm i Apelimit e ka sqaruar Komisionerin Publik Saraçi se i ka vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në funksion të realizimit të procesit, dhe se pretendimet e tij për mosplotësim dokumentacioni ishin plotësisht subjektive dhe se nuk kishin asnjë bazë ligjore.

Komisioneri Publik Saraçi refuzoi të bashkëpunonte me dy anëtarët e tjerë të Komitetit *ad hoc*, për të përmbushur detyrimet e parashikuara nga neni 22 pika 2 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon se: “*Procesi i rekrutimit bazohet në një procedurë të hapur dhe transparente për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga Komiteti ad hoc i krijuar në institucionin përkatës*”.

Në mbledhjen e Komitetit *ad hoc* të datës 21.12.2017, Komisioneri Publik Saraçi u largua nga mbledhja e Komitetit *ad hoc*, me pretendimin e paqartësisë së tij për bazën ligjore të veprimtarisë së këtij organi, dhe me kërkesën e përsëritur për njohje me akte, që nuk kishin asnjë rëndësi për vijimin e procesit të rekrutimit të stafit.

Në këto kushte, kur veprimtaria e Komitetit *ad hoc* ishte bllokuar, Mbledhja e Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në një mbledhje të jashtëzakonshme më datë 22.12.2017, mori në analizë situatën e krijuar. Mbledhja e Gjyqtarëve konstatoi se veprimtaria e Komitetit *ad hoc* ishte bllokuar për shkak të mospërbushjes së pajustificuar e në mënyrë të qëllimshme, të përsëritur të funksionit të anëtarit të këtij Komiteti, Komisionerit Publik Saraçi, në cilësinë e tij si Komisioneri Publik më i vjetër në moshë. Në kushtet kur moszgjedhja e këshilltarëve ligjorë vinte në vështirësi funksionimin normal të veprimtarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Mbledhja e Gjyqtarëve mori vendimin nr. 13, datë 22.12.2017, me të cilin vendosi:

“1.T'i kërkojë Komisionerit Publik z.Heral Saraçi të përmbushë detyrat e ngarkuara nga ligji nr 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si anëtar i Komitetit ad hoc të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

2.T'i kërkojë Komitetit ad hoc përmbylljen e procesit të vlerësimit të kandidatëve për këshilltarë ligjorë, brenda datës 26.12.2017.

3.T'i kërkojë dy anëtarëve përfaqësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në Komitetin ad hoc, që në rast të përsëritjes së veprimeve të Komisionerit Publik Saraçi, për bllokimin e veprimtarisë së Komitetit, të përmbylli veprimtarinë e kërkuar nga ligji për këtë Komitet, në mungesë të tij.

4.Të thirret Mbledhja e Gjyqtarëve më datë 27.12.2017, ora 12:00 ditën e mërkurë me rend dite, zgjedhjen e këshilltarëve ligjorë, mbi bazën e vlerësimit të kandidatëve që do të paraqiten nga Komiteti ad hoc.

5.Të njoftohet Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit për situatën e krijuar si dhe të ftohet, nëse e vlerëson të përshtatshme të marrë pjesë në datën 27.12.2017, ora 12:00, ditën e mërkurë.”

Ky vendim iu komunikua zyrtarisht Komisionerit Publik Saraçi dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Në mbledhjen e datës 22.12.2017, të Komitetit *ad hoc*, Komisioneri Publik Saraçi ka pranuar se ky Komitet kishte detyrimin të bënte vlerësimin e kandidatëve për procesin e përzgjedhjes së tyre, por nuk ka pranuar të vazhdojë ky proces vlerësimi. Gjithashtu, në këtë mbledhje, Komisioneri Publik Saraçi përsëri ka kushtëzuar veprimtarinë e tij në Komitetin *ad hoc*, me vënien në dispozicion të akteve që kishte kërkuar në komunikimet shkresore, të sipërcituara me Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Ky fakt provohet me procesverbalin e mbajtur në datën 22.12.2017, për mbledhjen e Komitetit *ad hoc*, i firmosur në këtë rast edhe prej Komisionerit Publik Saraçi. Një nga aktet që kërkonte të njihete me këmbëngulje Komisioneri Publik Saraçi ishte akti i brendshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për dokumentimin e zgjedhjes me short, të dy anëtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në Komitetin *ad hoc*, znj. Ina Rama dhe z. Luan Daci, megjithëse ishte njoftuar zyrtarisht në datën 21.12.2017 për zgjedhjen e tyre, nga Kryetarja e Kolegjit,

nëpërmjet komunikimit të Vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 6, datë 04.10.2017 dhe Vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 8, datë 17.10.2017. Kjo kërkesë e tij nuk ishte bërë më parë në procesin e zgjedhjes së Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në procesin e përzgjedhjes së disa pozicioneve të stafit administrativ të zhvilluar nga i njëjti Komitet *ad hoc*, në datat 17 nëntor deri në 22 nëntor 2017. Kushtëzimi i veprimtarisë së Komisionerit Publik Saraçi në Komitetin *ad hoc* me justifikimin se përpara se të përmbushte detyrën e tij duhej të njihej me aktet e kërkuara, në vlerësim të Komisionit Disiplinor është një mospërmbushje e pajustificuar e detyrës, në mënyrë të qëllimshme dhe të përsëritur.

Komisioneri Publik Saraçi nuk ka qenë dakord me zbatimin nga ana e tij të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese” dhe rregullores datë 06.11.2017 “Për veprimtarinë e Komitetit *ad hoc* për administrimin e procesit të emërimeve në Kolegjin e Apelimit”, për arsye se, sipas tij, kjo do të cenonte kompetencën e tij vendimmarrëse. Lidhur me këtë pretendim të Komisionerit Publik Saraçi, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën Nr.31/1, datë 20.12.2017, i kishte sqaruar Komisionerit Publik Saraçi se kjo rregullore nuk kushtëzonte dhe as cenonte veprimtarinë e tij në Komitetin *ad hoc*, duke e ftuar që të jetë i lirë dhe i përgjegjshëm në kryerjen e funksioneve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Nga procesverbali i mbledhjes së Komitetit *ad hoc* të datës 26.12.2017 rezulton se Komisioneri Publik Saraçi është larguar nga mbledhja në orën 15.00 dhe është rikthyer në orën 17.45 me justifikimin se kjo ka ardhur si pasojë e nevojës së tij për të formatuar në një kompjuter vendimin e tij personal. Ai ka depozituar personalisht në Komitetin *ad hoc* vendimin i tij të datës 26.12.2017 “Për pranimin në punë të këshilltarëve ligjorë të KPA-së” në orën 17.45, ndërkohë që paraprakisht ua ka dërguar me postë dy anëtarëve të tjerë të Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në orën 16.14, megjithëse ata po e prisnin në zyrë.

Në vazhdim të këtij procesi, Komisioneri Publik Saraçi nuk ka pranuar nënshkrimin e vendimit të datës 26.12.2017 të Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit “Për vlerësimin e kandidatëve për këshilltarë ligjorë”, për arsye se në bazën ligjore të tij nuk ishte përfshirë neni 18, pika 4 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe se ky fakt, sipas tij i mohonte të drejtën për vendimmarrje. Gjithashtu, për të njëjtat arsye, Komisioneri Publik Saraçi nuk ka nënshkruar as procesverbalin e mbledhjes së Komitetit *ad hoc* të datës 26.12.2017. Dy anëtarët zbatuan kërkesat e nenit 22, pika 2 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke bërë vlerësimin e kandidatëve për këshilltarë ligjorë, dhe përcjellë vendimin e tyre të datës 26.12.2017, Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Komisioneri Publik Saraçi, në datë 26.12.2017 ka marrë një vendim individual të tij: “Për pranimin në punë të këshilltarëve ligjorë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”.

Të njëjtat veprime dhe mosveprime Komisioneri Publik Saraçi bëri edhe në procesin e vlerësimit nga Komiteti *ad hoc*, të kandidatëve për këshilltarë ekonomikë të Njësisë së Shërbimit Ligjor, duke vijuar të mospërmbushë detyrimet e parashikuara në nenin 22, pika 2 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Edhe në këtë proces, vlerësimi i kandidatëve u bë nga dy anëtarët e tjerë të Komitetit *ad hoc*, pa praninë dhe pa bashkëpunimin e Komisionerit Publik Saraçi. Në përfundim të këtij procesi, Komisioneri Publik

Saraçi mori vendimin individual nr. 5, datë 18.01.2018 “Për pranimin në punë të 3 (tre) këshilltarëve ekonomikë në Njësinë e Shërbimit Ligjor”.

Komisioneri Publik Saraçi, veç vendimeve të sipërcituara të datës 26.12.2017 dhe 18.01.2018, ka shprehur vullnetin e tij si anëtar i Komitetit *ad hoc* për pranimin në punë të punonjësve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit edhe në 4 vendime të tjera individuale:

Vendim nr. 1, datë 18.01.2018 “Për pranimin në punë të një specialisti IT”;

Vendim nr. 2, datë 18.01.2018 “Për pranimin në punë të një specialisti Arkiv/Protokolli”;

Vendim nr. 3, datë 18.01.2018 “Për pranimin në punë të një specialisti të burimeve njerëzore”;

Vendim nr. 4, datë 18.01.2018 “Për pranimin në punë të një specialisti financë/buxheti”;

Në të gjitha vendimet individuale dhe të njëanshme, që Komisioneri Publik Saraçi ka marrë lidhur me rekrutimin e këshilltarëve të Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe personelin administrativ, nuk jepet asnjë arsye për vlerësimin e kandidaturave që justifikon zgjedhjen e tij. Duhet theksuar se, në vendimin e tij të datës 26.12.2017 “Për pranimin në punë të këshilltarëve ligjorë të Njësisë së Shërbimit Ligjor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, Komisioneri Publik Saraçi emëroi tre kandidatë për të cilët dy anëtarët e tjerë të Komitetit *ad hoc* kishin arritur në konkluzionin që nuk përmbushnin kriteret ligjore.

Në të gjitha vendimet individuale dhe të njëanshme që Komisioneri Publik Saraçi ka marrë lidhur me rekrutimin e këshilltarëve të Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe personelin administrativ, ka urdhëruar Kryetaren e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për zbatimin e këtyre vendimeve. Në vlerësimin e Komisionit Disiplinor, këto urdhërime, janë haptazi në kundërshtim me kompetencat që neni 13 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ka ngarkuar Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe janë në tejkalim të kompetencave që ligji i nje Komisionerit Publik më të vjetër në moshë, në cilësinë e anëtarit të Komitetit *ad hoc*.

Në analizë të sa më sipër, këto veprime vlerësohen nga Komisioni Disiplinor si ndërhyrje dhe ndikim i papërshtatshëm i Komisionerit Publik Saraçi, në ushtrimin e detyrës së Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Gjithashtu, Komisioni Disiplinor vlerëson se veprimtaria vendimmarrëse e Komisionerit Publik Saraçi duhej të ushtrohej në kuadër të vendimmarrjes së Komitetit *ad hoc*, i cili ishte i vetmi organ që kishte të drejtë vendimmarrëse në përputhje me parashikimet e ligjit dhe nëse Komisioneri Publik Saraçi nuk do të ishte dakord me vlerësimet e dy anëtarëve të tjerë, mund të shprehte qëndrimin e tij nëpërmjet një mendimi pakice, të dokumentuar në aktet e veprimtarisë së Komitetit *ad hoc*. Komisioni Disiplinor vlerëson se nuk mund të konsiderohet përmbushje e rregullt e detyrës në kuptim të ligjit nga Komisioneri Publik Saraçi, vetëm njohja me dosjet e kandidatëve, prezenca e pjesshme formale e tij në mbledhjet e Komitetit *ad hoc*, si dhe vendimmarrjet individuale e të njëanshme të tij.

Për më tepër, në veprimtarinë e tij si anëtar i Komitetit *ad hoc* pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Komisioneri Publik Saraçi nuk ka nënshkruar disa procesverbale të mbledhjeve të këtij organi, me justifikimin se hartimi i tyre nuk bazohej në nenin 18, pika 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për

rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ose për shkak të largimit të tij nga mbledhjet e Komitetit *ad hoc*, si për shembull procesverbalet e datave 21.12.2017, 26.12.2017, 09.01.2018, 12.01.2018, 15.01.2018, 16.01.2018, 19.01.2018.

Komisioneri Publik Saraçi ka ndërprerë veprimtarinë e tij si anëtar i këtij Komiteti *ad hoc* pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në datat 05.02.2018 dhe 06.02.2018 për arsye pamundësie shëndetësore, por nuk njoftoi për këtë situatë anëtarët e tjerë të Komitetit *ad hoc* të Kolegjit. Kjo sjellje e Komisionerit Publik Saraçi është e papranueshme, pasi ai i kishte të gjitha mundësitë objektive për të njoftuar me çdo mënyrë të mundshme, për pamundësinë e tij shëndetësore për të realizuar detyrimet e tij si anëtar i Komitetit *ad hoc* në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

Në vlerësim të Komisionit Disiplinor, këto veprime të Komisionerit Publik Saraçi, përbëjnë një sjellje të papërshtatshme dhe të përsëritur të tij me dy anëtarët e tjerë të Komitetit *ad hoc*.

Largimet e tij në disa raste nga mbledhjet e Komitetit *ad hoc* konsiderohen nga Komisioni i Disiplinës edhe si mospërbushje e pajustificuar, e qëllimshme dhe e përsëritur e funksionit të tij në Komitetin *ad hoc*.

Në analizë të sa më sipër, lidhur me veprimtarinë e Komisionerit Publik Heral Saraçi, si anëtar i Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Komisioni Disiplinor vlerëson se me veprimet dhe mosveprimet e tij:

- nuk ka përmbushur në mënyrë të pajustificuar, të qëllimshme dhe të përsëritur detyrat e tij funksionale;
- ka ndërhyrë dhe ndikuar në mënyrë të papërshtatshme, në ushtrimin e detyrës së një anëtari tjetër të institucioneve të rivlerësimit;
- ka shkelur rregullat e sjelljes në marrëdhënie me anëtarët e institucioneve të rivlerësimit;
- ka shkakuar vonesa dhe zvarritje të përsëritura dhe të pajustificuara të veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit.

Si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të Komisionerit Publik Saraçi, si anëtar i Komitetit *ad hoc* të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, procesi i pranimit në punë të këshilltarëve të Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe personelit administrativ të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është vështirësuar artificialisht, duke u zvarritur në mënyrë të pajustificuar, si dhe ka konsumuar shumë energji dhe kohë të panevojshme të anëtarëve të Komitetit *ad hoc*, të anëtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe të vëzhguesve ndërkombëtarë, duke vënë në rrezik besueshmërinë e procesit të rekrutimit, si dhe funksionimin normal të veprimtarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioni Disiplinor, pasi mori në shqyrtim të gjitha provat e nevojshme të paraqitura nga gjyqtari hetues dhe nga Komisioneri Publik nën hetim, Heral Saraçi, e ftoi gjyqtarin hetues dhe Komisionerin Publik Saraçi të parashtronin konkluzionet e tyre përfundimtare, lidhur me përfundimin e procesit disiplinor.

Gjyqtari hetues, në konkluzionet përfundimtare konkludoi se: “Nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve Komisioneri Publik Saraçi ka konsumuar elementet e neneve 16/4, 16/5, 16/7 dhe 16/8 të Ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë”, si dhe krijojnë dyshimin e arsyeshem që subjekti nën procedim disiplinor ka kryer shkelje disiplinore dhe për këtë arsye kërkoj të merret një masë disiplinore, siç e çmon Komisioni Disiplinor, ndaj tij”.

Komisioneri Publik Saraçi dhe avokati i tij mbrojtës Shaqir Hasanaj, në konkluzionet përfundimtare deklaruan se, në vlerësimin e tyre Komisioneri Publik Saraçi nuk ka kryer shkelje disiplinore dhe për pasojë nuk duhet marrë masë disiplinore.

Komisioni Disiplinor, në përfundim të shqyrtimit të procedimit disiplinor, duke analizuar të gjitha faktet juridike të treguara më sipër, arrin në konkluzionin se:

Komisioneri Publik Saraçi me veprimet dhe mosveprimet e tij ka kryer shkeljet disiplinore të parashikuara nga ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe konkretisht si më poshtë:

- Ndërhyrje dhe ndikim i papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës së një anëtari tjetër (neni 16, pika 4);
- Mospërmbyshje të pajustificuar e të qëllimshme, të përsëritur përkatësisht të funksioneve të tij (neni 16, pika 5);
- Shkelje e rregullave të sjelljes në marrëdhënie me anëtarët e institucioneve të rivlerësimit (neni 16, pika 7)
- Vonesa dhe zvarritje të përsëritura dhe të pajustificuara të veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit (neni 16, pika 8).

Këto shkelje, duke u bazuar në pasojat që kanë sjellë në rrezikimin e veprimtarisë normale të Institucionit të Komisionerëve Publikë, të Institucionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe të vetë procesit të rivlerësimit në tërësinë e tij, konsiderohen se janë shkelje shumë të rënda dhe për pasojë është e domosdoshme marrja e një mase disiplinore të përshtatshme, ndaj Komisionerit Publik Saraçi.

Në vlerësimin e rëndësisë së shkeljes dhe caktimit të llojit të masës disiplinore, Komisioni Disiplinor ka marrë parasysh: llojin dhe rrethanat e shkeljes; shkallën e fajësisë dhe motivin; pasojat e shkeljes; masën e rrezikut të shkaktuar nga shkelja disiplinore; rrethanat e rëndësishme që kanë lidhje me shkeljen; sjelljen e Komisionerit Publik Saraçi pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit; sjelljen e tij jobashkëpunuese gjatë procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mbajti ndaj tij si dhe ekzistencën e më shumë se një shkeljeje, në mënyrë të përsëritur dhe të vazhdueshme.

Në caktimin e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor, bazuar në sa më sipër vlerëson se shkeljet disiplinore të kryera e bëjnë Komisionerin Publik Saraçi të papërshtatshëm për vazhdimin e mëtejshëm të ushtrimit të funksionit të tij. Për rrjedhojë, Komisioni Disiplinor arrin në konkluzionin se e vetmja masë e përshtatshme disiplinore, që i përgjigjet rëndësisë së shkeljeve disiplinore është **“shkarkimi nga detyra”**.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Disiplinor, bazuar në nenin C, pika 16 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 16 dhe 17 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

Shkarkimin nga detyra të Komisionerit Publik Heral Saraçi.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 12.03.2018.

Anëtar
Gjyqtar


Ardian Hajdari

Anëtar
Gjyqtar


Albana Shtylla

Kryesues
Gjyqtar

